

8JH-1
8j'80

poezi

Balil
Gjini


Përurim

8JH-1
8.80



BALIL
GJINI

Përvurim



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor
FOTO MALO

Recensues:
Fisnik Sina
Shefki Karadaku

Kënga e viseve të mia

Këngë e ashpër e viseve të mia,
në zgripin e shekujve —
dafinë e gjelbër buzë honít.

Gratë
me zjarr rrufesh t'i bënë qëndismat,
burrat
gjëmimin e reve futën brenda gjoksit.

Këngë e dashur!
Mbi zemrat e njerëzve të mi
je mbështetur në dasma e sulme.
Herë nga thirrjet gjëmon pushka e
trimave,
herë nga fjalët del parfumi i luleve.

Fidanët e rinj

Ju shkulën një ditë dhjetori punëtorët
prej fidanishtes, truallit nënë,
mbështjellë me pak baltë të kuqe
si me pak vendlindje ndër rrënje.

Ju jeni të vegjël dhe nuk e ndieni
sa e shtrenjtë kjo baltë do t'ju jetë:
pa të dhe vetë ne, njerëzit,
nuk mund të rrënjojmë në jetë.

Vendlindjes

Vështroj furrat e metalurgjisë,
e, përmes flakës ku shkrihet metali,
më shfaqen imazhet e fëmijërisë,
ku udhën nisa nën çika stralli.

I kam ende shenjat në këmbë
vrarë lëndinave në Mushajadhë.
Shpesh dorën mbi flokë kam vënë
sikur kërkoj qeleshen e bardhë.

Kam mall të dal te bregu ynë,
në lëndinat plot zile e çokane.
Në se mbaj tani pardësynë,
shpesh supet më hanë pér të dhirtën llabane.

Trualli lab më lindi një ditë
nën lisat si djepe pér çerdhet e zogjve.
Fshati im shtrirë në një brinjë,
hapur si krah i fuqishëm shqiponje.

Drinos

Kurrizpërskuqur ti vije dimrave
e prapë me furi brigjet sulmoje.
Unë hipur mbi urë
si mbi një kalë
të sodisja i heshtur e mrekullohesha.

Natën në gjumë, me frerin e ëndrrave
të têrhiqja, të têrhiqja...

isha fëmijë.

Nga frika mos të shihja verës vrullpaktë
të futa brenda damarëve të mi.

Gryka e Këlcyrës

Malet janë aq të thepisur, sa reve
që porsa dolën mbi kreshta tanë,
s'do ishte çudi t'u merreshin mentë
e të rrokulliseshin poshtë, në greminë.

Mes gjymtimit madhështor të peisazheve
vjen Vjosa që do, por (ah!) s'mundet të ndalet.
Befas bubullin dhe shpatet jehojnë
sikur bubullimën përqeshin me tallje.

Grykës së Bënçës drejt Progonatit

Mbi shkëmbinjtë e kuq
(gjurmë të luftërave)
kthetrambërthyer rri një shqiponjë.
Tek shoh atë them me vete:
Ja motra e vogël e Labërisë sonë.

Gjithçka madhështore!
Malet dhe njerëzit
s'kanë sinonim tjetër veç heroizmit.
E vëtmja pamje e brishtë është ky lumë,
i holluar dhe vetë prej hutimit.

D r i n

Duke çarë me bërryla malet,
fushat dhe grykat
që prej lashtësisë,
me mesazhe drejt njëri-tjetrit vinin:
Drini i Bardhë,
Drini i Zi.

Me vetëdije
zulmën vetjake
brenda ligenit e flijuan një ditë.
Kështu i humbshim të gjitha epitetet:
në dritë...

Copëra stralli

Erozioni dhe koha
shkëmbinjtë e tjerë
ja si i kanë bërë:
thërrmia-thërrmia.

Strallet qëndruan, se brenda vetes
kanë pasur prush e shkëndija.

Dhe shih si të shfaqen:
fare të thjeshtë,
shpërndarë në çdo breg e çdo pllajë,
ndonëse farën e flakës së yet
më të lashtë se zjarri i Prometeut e kanë.

Përcëllima¹⁾

Përcëllimë!

Ç'e kishe vallë atë emër ashtu?...

Sa të shqiptova emrin,

tingujt në ajër

m'u dogjën e m'u shndërruan në shkrumb.

Të digjnin shpinën

diejt e verërave.

Të plevitosnin erërat e dimrave.

Ne që të donim,

 të hodhëm ndër krahë

gjelbërimin e pishave.

1) emër vendi

Mes shegëve të egra

Tek e têrhiqnin të vrarë partizanin,
s'patën kohë t'ia numëronin plumbat në gji.
Ndoshta qysh atëherë këto shegë u çanë
për t'u kujtuar njerëzve plagët e tij.

Thëllëzat tona

— Muhedin Sherifit —

Atje ku re ti,
një trumbë thëllëzash
fluturuan dhe m'u duk se më thanë:
— Kur ra, ne iu mblozhëm përreth
dhe gjaku pikëloj krahët tanë...

Muhamet Gjollesha

Krap-krup, krap-krup atë mesnatë me ngricë
(s'ishin kuajt e fshatit që këputnин bar).
Vdekja mbathur me këpucë milicësh
po të conte, Muhamet, në litar.

U ndalën. Një pemë. Heshjte. Errësirë.
(Pështymë! E madhe sajomu në gojë.)
Retë në qiell, si nënët shamizeza,
t'u afruan me pisha vetëtimash në dorë.

Zgjerohet retina e syve të tu, vëlla,
Atdheun ta futësh në bebëzat e tyre.
Duke të shkëputur fashistët prej tokës,
ti po merrje diçka nga përjetësia e yjeve.

Me ujitesit natën

Për t'u ndihmuar sadopak njerëzve
që lodhen brazdë më brazdë,
gjithë xixëllonjat i ndezën
neonet e vogla nën bárk.

Kur vjen mëngjesi, hapat
kujdes kur t'i hidhni në fushë.
Bimët me vesë të kristaltë
si me zilka të vogla në gushë...

Shiu i verës


Era e ngre pluhurin lart si shtëllungë
dhe gjethë e letra mbledh në cepin e fushës,
pastaj pikat e shiut
me ritëm daullesh
mbi gjethet e misrit trokasin gëzueshëm.

Prashitësit shohin si rrzuujt e qelqtë
gjethet me tehun e vet i thërrmojnë.
Shtrijnë krahët,
se pikat e vogla u dhimbsen
dhe duan t'i prsin në dorë...

Mbrëmje në Lazarat

Grupe-grupe kthehen bujxit në muzg.
me atë shkujdesje
që ta jep vetëm puna.
Farës së re tani në fushë
buzët e plisave i mërmërisin ninulla.

Fara e grurit
në brazda bisedash
kishte kaq kohë që ushqëhej me vlagë...
Plepat ndanë xhadesë më shumë se nga era
përkulen nga respekti për ta.



Rënia e déborës

Qiellin, që dukej krejt i pafajshëm,
befas një bubullimë
e përshkon tejendanë.

U trembën pëllumbat në guvat e reve,
rrahën krahët
dhe puplat mbi tokë u shpërndanë...

Lulëzimi i kumbullës

Në mëngjes
krahu i gjatë i një shpendi
pas xhamit të dritares përplasej,
përplasej....
Oh, qenkësh dega e kumbullës
që e pëllumbtë ish bërë brenda natës.

Lulet e shegëve

Ka ardhur maji
dhe lulet e shegëve
të kuqe, flakë, përskuqin si shpuzë.

Në ç'natë, vallë
zbritën yjet nga qelli
dhe i puthën luleshegët në buzë?...

Zjarret e pranverës

U ndezën në degë lulet e lofatës,
era e funddimrit
u fryn me bulçinj: fuu, fuuu...
Ç'bën kështu, erë e marrë?!
s'shuhen zjarret e pranverës kështu!

Shpella në hyrje të galerive

Moj shpella me vulë të kuqe,
dyzetë e gjashtë sënduqe...

(Nga një gojdhënë popullore)

C'të fshehta ka dashur të nxjerrë kjo shpellë?
C'thesare poshtë vetes mbante vallë?
Te plasat e shpellës hapur si gojë,
populli parandiente galeritë e mëdha.

Kjo kohë gojëdhënës diell i dha...

Minatorët

Me veshjen e thjeshtë, me autobusët urbanë
mëngjeseve e mbrëmjeve nisen në minierë.
Jeta mbi tokë aq e madhe për ta,
sa një pjesë ia japin nëntokës së thellë.

Një tundje dore, një bisedë të ndërprerë
e lënë aty, te gryka e galerive.
Karrierist! Ecja e tyre të thotë se shpesh
lartësitë e jetës nisin poshtë, thellësive.

Përvimi

U thanë të gjitha...

**Pastaj furrat uzina i ndezi:
flaka e kuqe,
tymi i zi.**

Atdheut iu shtua dhe një flamur i ri.

Një murator së dashurës

Shihe pëllëmbën time, e dashur:
vërtet e ashpër,
por prapë e ngrohtë.

Ja, gishtat i mblodha.
A s'të duket si çerdhe?!...

Tani në të mund të ulen zogjtë.

Vizatim i ditës së parë të pranverës

Bashkë me stinën u ndërruan dhe turnet,
ikin e vijnë djemtë nga uzinat.

Retë si rroba të përdorura tepër
dimri i arnon me penj vetëtimash.

Me atë borëzim petalesh bajamet,
porsi nuset që nesër martohen.

Sqetullat e kodrave mbushen nga bari,
qiejt nga cicërimat e zogjve.

Turfullojnë përrenjtë, të bindur se ujin
padrejtësish të dëbora ua ka ngarkuar mbi
shpinë.

Thérresin qengjat ndër vatha, sikur
nga gjintë e pranverës kërkojnë të pinë.

Përhidhet gjuha e flaktë e fabrikës,
sikur dhe ajo diçmatet të thotë.

Sonte s'do ish çudi që yjet e qiellit
më pikat e vesës t'i gjenim mbi tokë.

Kjo ditë që po ikën

Kooperativistet ndanë kombajnave
mbledhin ndër krahë duajt e fundit.
Kjo ditë që po ikën

në ijet e saj
është ngarkuar me peshën e grurit.

Ca kokrra gruri në duart e mia,
me ato vijëza të vogla në mes;
në buzët e tyre si në gremina
janë rrëzuar të uriturit gjatë shekujve.

Tek hedhin grurin me lopata në erë
vajzat vetullhëna të brigadave,
me mend, kërkojnë petësit në shtëpi,
për të gatuar byrekët e dasmave.

Më tej traktorët nisin të plugojnë
dhe gati për farën arat u bënë.
Tokë e mrekullueshme! Ende lehonë
përsëri shtatzënë...

Gurët e fshatit

Mbi atë shpellë maja e fëndyellit
m'i ka gjakosur shpeshherë pëllëmbët
dhe sa herë i bija culës a fyellit
në vrimat bënин folenë pëllumbat.

Po gurët e fshatit të mësuar që unë
t'i fërkoj lehtas vetëm me shollë,
kërcasin tani nën sandale plot zhurmë:
— S'të njohim. Cila je? — sikur thonë.

Si s'më njihni, o gurë?!... Jam ai fëmijë
që s'linte dy gurë bashkë në lagje.
Ju vetë e rritët dhe i zgjuat atij
idealet e një jete të madhe...

Në shtëpinë e gjyshes

U drodhën karafilat e kuq sa më panë
tek porta mua, mikun e vjetër.
Hapën petalet si buzë e më thanë:
— Gjyshja ka dy ditë pa na prekur.

E dhembshur, e shtrenjtë! Që prej saksive
sa herë për mua karafila këpüte?...
Zgjata duart... Ca gjethe hardhie
më zgjuan duke më trokitur mbi supe.

Gjyshja atje... Po vallë përse
zbardhët sikur s'e kishte gjakun në trup?!
— Gjithë gjakun e la te nipat e ne —
më thanë nga dritarja karafilat e kuq.

Largim prej vendlinjës

I mora të gjitha:
librat, ndërresat
dhe fotot e të dashurve.

— Të gjitha, të gjitha, vërtet?! — pyet zemra
Ah! Rrugët...
Ato si mund t'i mbështillja
në valixhet e rënda?...

Lapidari i heroit

(Heroit të Popullit Bajram Curri i është ndërtuar një lapidar në formë pushke)

Gjithë jetën me pushkë... dhe kurrë
s'ëndërroi për veten buste mermeri.
Dhjetë gërmat, si dhjetë fishekë,
si në krehër i janë lidhur mbi emrin.

Edhe pas rënies pa pushkë s'mund të rrinte
(është kohë e ashpër me luftra agresore).
Dora e tij shtyu plisat e gjelbër
Edhe pas rënies pa pushkë s'mund të rrinte

Në kufi

Gëzhoja të zbrazëta të ndeshjes me shkelësit
aty-këtu janë shpërndarë nëpër tokë.
Marr një gëzhojë. E vogël sa gishti,
sa një jetë njeriu më peshon në dorë.

Toka ime! Shkëmbinjtë-piramida,
edhe bari është shtizëruar mes gurësh.
Këtu gjithçka ka një ngjyrë të tillë
sikur toka është mbjellë me farë flamurësh.

Pak kohë nga stërvitja

Ish dhënë komanda për ecje rreshtore,
kur befas ndaloi i pari; i dyti...
Një çerdhe zogu ndanë shtegut qëndronte,
fshehur në barërat e bruzta të prillit.

Brenda tre zogj tē vegjēl, pushhollē,
tē pamësuar tē hapnin kapakët e syve,
zhurmat e hapave tē ushtarëve i morën
për rrähjet e krahëve tē nënës së tyre.

Ndaj hapnin sqepat aty, mes ferrishtes, ndërkaq pat ndaluar i treti i dhjeti...

— E tmerrshme do ishte folenë mos ta shihje — i thotë i dyti të parit të rrështit.

Një përkujdesje jo e kotë për zogjtë
aty te qafa ku erërat fryjnë...
ishte mesditë dhe radioja ndërkohë
fliste për krimet në Salvador, Palestinë...

Kur lexoja Makbethin

Kur unë lexoja Makbethin netëve,
diku, pas gazetës pashë gjakun katran.
S'ish gjaku i Bankos, por gjaku i shteteve,
që kacafyteshin për naftë e uran.

Më dukej se brigje të tëra
i shihja
brenda barkut të Shtëpisë së Bardhë,
por senatorët s'i dridhte zëri i kukuvajkës,
as fantazmat në kolltukët presidencialë.

Kur unë lexoja Makbethin netëve,
rrugët e krimeve më çonin në Afganistan,
të qeta flinin gratë e presidentëve,
ndonëse gjakun s'e lan asnje oqean.

Para gjëmave të usurpatorëve të sotëm
një xhuxh-kalama është Makbethi i shtrigës...
Për drurin e pushkëve të proletarëve
globi, për ta, rrit Pyllin e Brinjës.

Ardhja e dallëndysheve

Çvit-çvit dallëndyshet
çvit-çvit.

Krahët e zinj,
gjoksi i bardhë.

(Sikur gjatë rrugës nga erdhën
hijet dhe dritat e botës kanë marrë.)

Që poshtë reve të marsit:
çvit-çvit, çvit-vit,
sikur duan të dinë patjetër
në ç'vit jemi tanë, në ç'vit?...

Po vijnë nga vise të largëta,
kaluan mes tymit e zjarrit
e ndoshta, nga ç'panë,
u falet
që harruan për pak kalendarin...

Vazhdimi i ditarit të Ana Frankut

Ju s'mundët t'ia lexonit ditarin të tërë,
sepse në një ditë të rëndomtë e vranë.
Përreth-ulërima rrëqethëse e erës
që kërkonte t'i mpikste gjakun mbi plagë.

Por vrasësit prapë mund të vijnë një ditë,
kur ju të ëndërroni plazhet buzë deteve,
me ëndrrën e çmendur që botën ta krijojnë
duke bashkuar buzët e dy helmetave.

Mos u çuditni! Ata flasin për paqen.

Buzëqeshin:

Bëjnë tek njëri-tjetri vizita të pafundme;
veç tymi paqësor i llullave në bankete
mund të shndërrohet prapë në tym
krematoriumesh.

Vrasësit, nga gjithë lulet, adhurojnë më tepër
trëndafilat e gjakut në këmishët e të vrarëve.
Njerëz! Është detyra jonë që atyre t'iu veshim
si këmishë të zezë baltën e varreve.

Pavdekësia e Marksit

Kortezhi i proletarëve kokulur, ngadalë,
ecte mes sheshit me trupin e Marksit.

Ejani, vini një sup arkivolit,
ju ditë dhe shekuj të ardhshëm.

Po heshtëte shtypi. Kambanat e kishës
asnjë tingull s'lëshuan prej fytit të zi.
Londër borgjeze! Marksit s'u shtri për të
vdekur,
po për të mbajtur planetin mbi shpinë.

16 tetor 1985

Nxënësit të rreshtuar presin që mësuesja
diçka për jetën e Udhëheqësit t'u thotë,
por prej syve të saj
rrjedhin lotë.

Në ata sy
si në dy ekrane
(afrohuni mirë t'i shihni)
traktet e para, shtigjet partizane,
pikat e gjakut mbi dëborën e dimrit,
turbinat, furrnaltën,
fushat nga mori ngjyrat ylberi
dhe një popull me grushte në tëmtha
i betuar të ecë në rrugën e Enverit.

Të heshtur nxënësit!
Gjethet e akacies
përpëliten si krahë të një fluture.
Por nxënësit kuptuan:
duartrokisnin, duartrokisnin...

Për Enver Hoxhën ishte folur aq bukur.

Enea dhe statujat e Butrintit

Mes këtij amfiteatri Enea është ulur flokëpluhurosur prej udhës; ka qarë, flokët e vet ka shkulur i rrëthuar ngado prej statujave.

Ngjarja ish aq e tmerrshme, sa mermeri plasi prej peshës tragjike të saj.

Me këto plasa si sy

qysh atëherë

statujat né horizonte kanë parë.

Hirin e Trojës era në kthethra
e merrte dhe retë dimërore hirnoste;
pikat e shiut me të tek përziheshin,
i thërrisin vigjilencës së popujve.

Monolog i sultani Muratit nën muret e Krujës

Kot po mundohen pashallarët e mi
të më fshijnë shkumën e vdekjes prej buzëve.
Për mua, Muratin, sultani dhe emir,
qenka e thënë të vdes nën këta mure.

Atij që do të gjunjëzonte të mallkuarën
kështjellë,
i premtova florinj sa ka qelli yje.
Kohrat s'e rrahën atë me breshër e erë
sa e rraha unë me katapulta e gjyle.

Çadrat si kërpudha i ngula në këto anë,
t'u thithnin jetën krahinave shqiptare,
por të pafetë si xhinde që janë
thërrisnin në ndihmë dhe karvanet e maleve.

Kjo kështjellë bedenashembur nga topat,
që me gjakun e kaq jeniçerëve është larë,
e nxirë tani prej barutit të luftës,
më duket si xhebraili që vjen të më marrë...

Një mëngjes

Vazhdonte shiu... Para se të hynte,
vetë drojtja trokiti te dera ngadalë.
Pikat e shiut prej flokëve të qullur
i kullonin poshtë te këpucët me baltë.

Brenda hapësirës së madhe të klasës
erërat që hynë me të sikur thanë:
— Ne që e shoqëruam, ia dimë shkakun
vonesës,
ndaj ikursesi mos e lër jashtë.

Vonë, shumë vonë mësova se asaj
i duhej të conte vëllanë e vogël në çerdhe,
dhe rrugës për shkollë nxitimthi pastaj
bishtra vetëtimash kish shkelur mbi pellgje.

Atë ditë nëna e saj ra e sëmurë
dhe babai lëronte diku me traktor.
S'mund të harroj që, prej rutinës së punës,
një rrudhë i shkaktova fytyrës së njomë...

Në pushimet verore

Klasat heshtin.

Zhurmat e dikurshme

flenë mbi bankat e heshtura.

Do kërkoj në klasë:

kur ikën nxënësit,

patjetër i lanë diku të qeshurat.

Do t'i tremb si shpendë. Të rrahin krahët
në mure,
se s'mund ta duroj këtë heshtje të murme.

Selvitë para Teqesë së Zallit¹⁾

Këta drurë jeshilë, të errët,
që nga era kërrusin shtyllën vertebrore,
i pëlqenin shumë babait të teqesë atëhere,
se rrinë me krahët në gjii si shërbëtoret.

O qenie fatkeqe me hir të gënjeshtërt,
me atë kurorë si gjuhëz qirinjsh!...
Pështymat e njerëzve që gënjet gjer dje
mbetshin për ju i vetmi nderim.

1) Teqeja e Zallit — Ish-qendër e reaksionit
klerikal pranë qytetit të Gjirokastrës

Manastiri i kallogreve

Në pirgjet e gurëve kanë mbirë hitrat,
për të dëshmuar sa e hidhur qejeta.
Këtu vajzave të bukura, hënësfiduese,
brengat u hynin në zgavrat e eshtrave.

Dhe rriteshin brenda trupit të tyre,
duke ua kafshuar nga brenda rininë,
ndaj shpeshherë prej grykës së pusit
me trup e thyenin të ujit pasqyrë.

Pse e ndërtuan mbi këtë hon
larg njerëzve dhe zogjve të bukur?!
Bah! Cicërimat kallogreve do t'u kujtonin
zëra fëmijësh, djepe për t'u tundur.

Mbi pllaka ca figura e shenja,
vizatuar me kongjij nga një dorë femërore,
janë dëshmitë e pagoja që tregojnë
si i vriste ajo kohë jetët njerëzore.

Vajzat e frutikulturës

Kur kalojnë para djemve, këto vajza çapkëne
shtiren serioze,
hijerënda, të vrenjtura,
pa shpejtojnë të ikin sa më parë më tej,
në cepin e shamisë t'i mbytin të qeshurat.

Pak ujë në zverkun e shoqes,
që nga të qeshurat
të tunden si vathë lulet e qershive.
Po kaloi kush andej me poza autoritare,
le të bëhet lulëkuq nga romuzet e tyre.

Mëngjes për mëngjes

tek i sheh me gërshëreë
të krasitin me aq kujdes secilin nga drurët,
s'ke si mos t'i pyesësh:

— Ej, vajza të bukura,
te cilët prej tyre ju shihni dhëndurët?...

Përsëri

Fjalët e tua në ato ditë pranverore
m'u dukën ca cicërima të vogla fare.
Rrugët zhurmonin prapë nga ata njerëz
që jetojnë me këtë kohë shqetësimmadhe.

Ëndërrove një qetësi të butë konforti
(Jashtë zërin tim e kishe aq pranë)
Pa mendo sa i zymtë do të qe parku,
pa njerëzit që mbollën në të jargavanë?

Ti ndoshta ëndërron përsëri
transferimin tim dhe... shtëpi në qytet.
Në i gjeç fijet që kjo kohë na lidh,
ti prapë eja. Unë po të pres...

Ty që të dua

Ne ecnim rrugës së fshatit
dhe plepat
përsëritheshin disi monotonë.

Ata ishin ca lloj piketash që matnin
sa e gjatë do ishte biseda jonë.

Me krahët mbi supet e njëri-tjetrit
na dukej se dhe ylberi atje, matanë,
një imitim ynë ishte,
derisa
kishte po atë kurbë të krahëve tanë

Dimri me shkrepje të shpejtë vetëtimash
fotografonte gjithçka shikonte përreth,
që vitin e ardhshëm prapë këto pamje
t'i riprodhojë sipas të njëjtit model.

Do të përsëritheshin peizazhet e mjegullat
e ndoshta pse jo, dhe unë e ti,
veç kësaj rruge deri atëherë
do t'i shtojmë dhe një tjetër njeri...

Hëna

I vogël kur isha, hënën përgjoja
të dilte buzë malit, në skaj.
S'më zinte gjumi gjersa yjtë t'i shikoja
të zbehur prej bukurisë së saj.

U rrita... drejt teje, e dashur, tanë
me mendimet e kohës vij sërish.
Mbi lulet e mimozës që mblodha për ty
kam thërrmuar hënën e bukur të fëmijërisë.

Një re e vogël në shpat të Tomorrit

Një re qumështore
e vogëlzë fare,
e butë, leshpruar
si qengje manare.

Porsa njoju tokën,
nënëzën e dashur,
çdo gur puthi ngrohtë
me buzën e lagur.

Përdredh belin, hidhet,
luan si në valle
dhe nga dashuria
shkrihet, tretet fare.

Për njerëzit e mi

(poemë)

1

Rrihte pulsi i jetës te gjyshi, babai,
në damarët e bijvë
që erdhën më pas.
Iknin jetëbukurit...

Sahati i gjakut
në zemrën e brezave
vazhdon të trokasë.

O ti gjak i bukur i njerëzve të mi,
i ngrohtë valë
dhe mes kallkanit të dimrit!
Ç'trokisje ashtu,
sikur jashtë do të dilje ti,
të përskuqje agimet që do të vinin?!

Ishit krenarë ju, tepër krenarë.
Varférinë e fshihnit
nga sytë e botës.
Krahët e xhamadanit
ndaj 'erérave 'hapur
sikur kishit dëshirë fluturimin e zogjve.

Shihnit dafinat:
Kokrrat e tyre të zeza
sikur paralajmëronin rreziqet e vdekjes;
por ju, kokëkrisur, e kërkonit lavdinë
mbi tokë
namin e emrit të linit pas vetes.

Veç ditëve nga të pangrënët u merreshin
këmbët
dhe njerëzve poshtë syve
u bëheshin rrathë të zinj.
Netëve
hëna e plotë zverdhonte tej reve
si kulaci juaj i misërt me hi.

3.

Heshtnit pranë vatrës me dorën nën mjekër.
Te xixat e perostisë
profetizonit monedha...

Të nervozuar godisnit kërcurin me mashë
dhe qindra xixëllonja fluturonin të trembara.

Dhe ju si shkëndijat.

Kundër pushtuesve
niseshit pothuaj çdo vit nëpër luftra.
Ju sillte këtu këngëvaji i nënave:
«Korbat ne, o djem me jetët e shkurtra!».

Plumbat që ju rrëzonin
i merrte edhe toka
dhe prej plagëve të saj rridhnin burime;
(Me gëzhojat që ju zbrazët kohrave
mund të pikëzohej perimetri i kufijve.)

Hidhnit ca çaste sytë mbi djepe
e te fëmijët
shihnit luftëtarët e rritur.
Dhe mbiujeta
siç mbin një bërthamë qershëie,
kur gjen një të çarë mes shkëmbinjve të
thepisur.

Mbas ndonjë deleje, mbetur netëve jashtë,
ëndërronit për të gjithë barazi.
Herë haheshit dhëmbë për dhëmbë me fatin,
herë zbuteshit
dhe i bënët nuska, hajmali.

Netëve të majit te syri i shtrungës
ëndërronit bukë, dritë e fletore.
Gjithë kamës-hamësit,
për t'ju mësuar shpinëkërrusjen,
të ulta i ndërtonin dyert e faltoreve.

Ju njerëzit e mi në kisha e xhami
kandile a qirinj ndiznit në terr.
Në buzë:

formula lutjesh arabisht,
në kokë:
 frazeologji ateiste përherë.

Si mund t'i duronit duart e këmbët,
fushat e pyjet në pranga robërie,
ju
që në çdo pikë gjaku në rrëmba
kishit bërthamën e një përmendoreje lirie?!

Shteti dhe feja si dy mokrra guri
vërtiteshin;
jetën tuaj bluanin ata.
Ulërinte beu, prifti, taksidari...
«Korba,

mallkuar zëri juaj i çjerrë: krра,
krра!...»

Ata ishin lubitë me shumë kthetra e gojë
(Në çdo dhëmb u zbardhte metali i armëve.)
Ju brenda vetes rritnit Gishton e vogël,
të vogël, por me zemrën e madhe të maleve.

Erdhi një ditë që Gishtua ndihej ngushtë në
përrallë,
Gishtua donte të bëhej njeri i gjallë...

Erdhi Çlirimë.
Një plak që nga larg
Vinte të shihte Shtëpinë e Partisë.
E puthte pragun me ngashërimë e mall...
— Të paçim sa malet, Enver, o dritë!

Përkedhelte gurët me duart e dridhura,
heshtte, mërmëriste, dëneste si fëmijë.
Në çdo pikë loti
bërthamat e dhimbjeve
po iknin përgjithmonë nga zemra e tij.

Moj dritare të Shtëpisë së Partisë,
me ç'drurë e xhamia i paskeni kanatet!
Nën ballin e njerëzve
ju zutë vendin e syve
për të parë në vitet e ardhshme.

8

Kur vjen pranvera
dhe bie gérshëra ndër dhen,
një zog i vogël në rrapi vajton
S'vjen kurrë më parë,
siç duket, pret
hallet i fshehur t'i qajë zogu gjon.

Për zogun vajtues në viset e mia
lindën balada që s'i njeh njerëzimi:
Ai ishë njeri,
por vëllait një ditë
iu sul poshtë tendës së gjerë të mërzimit.

Balada thotë se lugetër e xhinde
e shtynë t'i turrej gérshérëhapur vëllait...
Ah, ishte prona që i errte sytë
dhe te brirët e deshve
pa brirët e djallit.

Leshrangritur prej tmerri vëllai i bariut
qau... humbi veten... iu largua njeriut.

9

Pronë vëllavrasëse!

Viktima, përçarje,
për një ledh, dy drurë a tri kallza misra,
por u ngrit Partia e proletarëve
dhe hunjtë e gardhimeve
u shkulën prej tokës si dhëmballë të prishura.

Ua pretë mjekrën prej shkurresh maleve
që socializmi në të
të mos pengohej kurrë:
U thatë:
— Male! Tani që u bëtë të lirë,
kjo tokë ju do edhe juve dhëndurë.

Që poshtë tyre fushat nazike
ua zbutnin pak ashpërsinë e burrit.
Frym era e pyllit
dhe fushave si nuse
u shpupurit floknajën e artë të grurit.

10

Ju, njerëzit e mi, i «dogjët» etapat,
atë që duhej bërë nesër
e bëni që sot;
kështu si ju
më parë çelin gjethë,
pastaj lulëzojnë
ftonjtë.

11

Nisen bijtë tuaj mëngjeseve pas brazdave,
me veglat e thjeshta të punës mbi supe.
Kthehen atëherë
kur perëndimi majëmaleve
u hedh krahëve velenxa të kuqe.

Bijtë tuaj!

Një gazmore, një «thërrime»,
mjafton që ata të qeshin të çiltër, të bardhë,
të qeshësh ashtu, pa fare shpenzime,
duhet ta kesh shpirtin të madh.

Dhe sa seriozë!

Në shuplakat e pëllëmbëve
mbajnë gjithë veprat e Shqipërisë.
gruri para tyre përkulet me nderim,
se i njeh prindërit e vet të mirë.

12

Në pushimin e drekës te supi i shokut
mbështetni kokën të dremitni pak.

Të çuditshëm jeni:

zgjuar dashuria s'ju mjaftoka,
por dhe në ëndrra e ndani bashkë.

Ju s'prisni!

Kohën për dore e kapni
duke i treguar të tjera shtigje.
Xhaketat tuaja e dinë më mirë
sa të sakta kanë qenë njoftimet

metereologjike.

Ju, njerëzit e mi, jeni të thjeshtë
 përemrin «unë» nuk e lakmuat kurrë.
 Jetoni nën tjegullat e shtëpive të reja
 si nën valëzime flamujsh.

.....
 Në këtë kohë
 nga gjaku juaj ndonjë
 dalngadalë u lodh e u thyen.
 Një tjetër hapësirat e gjera të atdheut
 i sheh që pas mureve të një zyre.

Me «autoritet» kuadri ngarkuar fytyra,
 mbi tavolina, karrige
 pesha e mishit të tij plot dhjamë...
 Për një problem do t'i trokasësh në zyrë
 sa gishti tregues të të bëhet plagë.

Një tjetër në historitë e luftës rrëmon
 mos gjejë te fisi një plagë plumbi
 E pastaj të ligjërojë kudo:
 — Ne që gjakun derdhëm si lumi...

Ju, njerëzit e mi, s'mund të jeni të qetë.
Përroi i gjakut
ju vërshon në damarë.
Ngrini zërin,
dorën bëni gati:
— Harram qumështi ynë, bastardë!

15

Në këtë gjysmëshekull me vite-pranverë
si beben e syrit e doni Shqipërinë.
Dhe ishte e natyrshme:
ditën që iku Enveri
në gishtat tuaj sa askurrë nikotinë...

Gishtat, mes dhimbjes,
bashkoheshin në tëmtha.
Betimi: në rrugën e Enverit, me Partinë!
Ditët e reja mbi supet tuaja,
me dritë besimi në horizonte ndrijnë.

Rreh pulsi i jetës në damarët e mi,
në damarët e bijve,
të nipave më pas...
Sahati i gjakut kështu në përjetësi
me ritmin e kohës së re
do të trokasë.

PËRMBAJTJA

Kënga e viseve të mia	3
Fidanët e rinj	4
Vendlindjes	5
Drinos	6
Gryka e Këlcyrés	7
Grykës së Bëngës drejt Progonatit	8
Drin	9
Copëra stralli	10
Përcëllma	11
Mes shegëve të egra	12
Thëllëzat tonë	13
Muhamed Gjollesha	14
Me ujitësit natën	15
Shiu i verës	16
Mbrëmje në Lazarat	17
Rënia e dëborës	18
Lulëzimi i kumbullës	19
Lulet e shegëve	20
Zjarret e <u>pranverës</u>	21
Shpella në hyrje të galerive	22
Minatorët	23
Përurimi	24
Një minator së dashurës	25
Vizatim i ditës së parë të pranverës	26
Kjo ditë që po ikën	27
Gurët e fshatit	28

Në shtëpinë e gjyshes	29
Largim prej vendlindjes	30
Lapidari i heroit	31
Në kufi	32
Pak kohë nga stërvitja	33
Kur lexoja Makbethin	34
Ardhja e dallëndysheve	35
Vazhdim i ditarit të Ana Frankut	36
Pavdekësia e Marksit	37
16 tetor 1985	38
Enea dhe statujat e Butrintit	39
Monolog i sultani Muratit nën muret e Krujës	40
Një mëngjes	41
Në pushimet verore	42
Selvitë para Teqesë së Zallit	43
Manastiri i kallogreve	44
Vajzat e frutikulturës	45
Përsëri	46
Ty që të dua	47
Hëna	48
Një re e vogël në shpat të Tomorrit	49
Për njerëzit e mi (poemë).	50

Gjini, B.

Përurim' Poezi. [Red.: F. Malo]
T. «Naim Frashëri», 1987.
64 f.

(B.m.) dhe
(B.v.) :891.983-1

Gj .80.

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-82

Shtypur KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë 1987